



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P.nr.615/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërci, në lëndën penale ndaj të akuzuarit S.C., për shkak të veprave penale: I. Kanosje nga neni 185 par.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), dhe II. Mbajtja në pronësi, kontroll, apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.nr 1780/2018 të datës 10.08.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 16.04.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Arijan Xhema dhe të akuzuarit, me atë 18.04.2019 shpalli publikisht, ndërsa me datë 13.05.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S.C., nga i ati ..., e ëma ..., e vajzërisë ..., i lindur me datë ... në ..., me vendbanim në fshatin ... – Komuna e ..., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal ..., serb, shtetas i Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I

sepse,

I.Më datë 12.05.2018, rreth orës 12:00 minuta, në ..., në fshatin ..., komuna e ..., konkretisht afër kishës së fshatit ..., ka kanosur me armë të dëmtuarën S.P., ashtu që ditë kritike pasi që e dëmtuara S.P. kishte qenë duke u kthyer nga varrezat, pasi që kishte qenë për ta vizituar varrin e nënës së saj, për një moment nga mali kishte dalë i akuzuari me armë dhe e kishte kanosur të dëmtuarën me fjalët “e ku e ke tash ...” e dëmtuara nuk është përgjigjur fare nga frika kurse i akuzuari ka vazhduar fjalët “tërhiqe akuzën, që të bëhet më mirë, që mos ta djeg shtëpinë” për shkak se e dëmtuara edhe më herët kishte pranuar sms mesazhe kërcënues nga i akuzuari dhe e njëjta rastin e kishte hapur në polici, ndërkaq e frikësuar nga kërcënimi e dëmtuara i është përgjigjur “po do ta tërheqë”, ndërsa i akuzuari i ka thënë “kurrë më nuk do të bezdis” dhe ka shkuar në drejtim te pyllit.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Kanosje nga neni 185. par.4 të KPRK-së**

II

Në ditën, kohën dhe vendin si në pikën I të dispozitivit i akuzuari ka poseduar armë në kundërshtim me ligjin mbi armët në Kosovë nr.03/L-143 dhe atë armën e tipit AK-47 e markës “Cervena Zastava” e kalibrit 7.62 mm, me numër serik 145, si dhe kornize të municionit në të cilën kanë qenë 9 plumba të kalibrit 7.62 mm, ashtu që ditën kritike pasi që ka kanosur me po të njëjtën armë të dëmtuarën dhe pasi që e njëjta rastin e ka lajmëruar në polici, njësia policore e Stacionit Policor në Zveqan, pasi kanë shkuar në shtëpinë e tij në fshatin ..., të akuzuarin nuk e

kanë gjetur në shtëpi, mirëpo e kanë vërejtur në një afërsi prej 30 m nga shtëpia, me ç'rast i është dhënë urdhër nga policia që ta lëshoj armën dhe t'i ngris duart lart, i akuzuari ka vepruar në përputhje me kërkesën e policisë, pastaj armën së bashku me municion nga ana e të akuzuarit e kanë konfiskuar ndërsa të akuzuarin e kanë shoqëruar në polici.

Me këtë ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPPK -së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 73, 75, 80, 83 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

GJYKON

Për pikën I, për veprën penale: Kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK-së, i cakton dënim me burgim me kohëzgjatje prej një (1) viti.

Për pikën II, për veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i cakton dënim me gjobë prej 550 € (pesëqind e pesëdhjetë euro),

Gjykata, në mbështetje të nenit 80 të KPRK-së, të akuzuarit S.C., i:

S H Q I P T O N

1. Dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
2. Në këtë dënim të akuzuarit i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak nga data 12.05.2018 e deri me dt.12.07.2018.
3. Dënim unik me gjobë në shumë prej 550€ (pesëqind e pesëdhjetë euro) të cilën gjobë është i obliguar ta paguajnë në afat prej tre (3) muajve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe atë në 3 (tre) këste të barabarta. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse i akuzuari nuk e paguan këstin me kohë. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 46 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
4. Në mbështetje të nenit 374 par.3 e lidhur me nenin 69 të KPRK-së dhe nenin 282 par.2 nenpar.2.4 të KPP-se, të akuzuarit i shqiptohet:

Dënim plotësues - konfiskimi i sendeve dhe atë:

- a. Konfiskohet arma automatike AK-47 e markës "Cervena Zastava" e kalibrit 7.62 mm, me numër serik 145 si dhe korniza e municionit bashkë me 9 plumba të kalibrit 7.62 mm.
- b. Urdhërohet Policia e Kosovës që armën e konfiskuar ta shkatërroj sipas procedurave ligjore në fuqi.

5. Obligohet i akuzuari, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të ekspertizës psikiatrike shumë prej 122€, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumë prej 40€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
6. E dëmtuara, S.P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo juridik.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzë PP.nr 1780/2018 të datës 10.08.2018, ndaj të akuzuarit S.C. nga ..., për shkak te veprave penale: I. Kanosje nga neni 185 par.4 të KPRK-së; dhe II. Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPPK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale, në të cilën seancë i akuzuari nuk e kishte pranuar fajësinë. Gjykata nuk ka mbajtur shqyrtimin e dytë, mirëpo i ka dhënë mundësi palëve që të paraqesin kundërshtim sa i përket aktakuzës dhe pranueshmërisë së provave. Brenda afatit ligjor i akuzuari nuk ka paraqitur kundërshtim ndaj aktakuzës.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësorë ashtu që në këtë seancë i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, ndërsa është deklaruar i pafajshëm sa i përket veprës penale: Kanosje nga neni 185 par. 4 i KPRK-së. Po ashtu, në këtë seance, në cilësinë e dëshmitarit – të dëmtuarës është dëgjuar S.P., janë administruar provat materiale dhe palët kanë paraqitur fjalën përfundimtare.

Fjala përfundimtare e palëve:

Prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se në këtë çështje penale, nga provat e prezantuara si ato materiale ashtu edhe ato personale, u vërtetua në mënyrë të drejtë gjendja faktike se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, kjo gjendje faktike u vërtetua në bazë të dëshmive të siguruar nga Prokuroria gjatë hetimit dhe të administruar në shqyrtim gjyqësorë. Nga deklarata e dëshmitares S.P., dhënë në polici dhe gjatë shqyrtimit gjyqësorë u vërtetua se ditën kritike më datën 12.05.2018 rreth orës 12, deri sa e njëjta ka shkuar në varrezat e fshatit në ... për të vizituar varrin e nënës, dhe pas kthimit duke ecur rrugës drejt kishës se fshatit për një moment nga mali ka dalur, tani i akuzuari më armë në dorë duke e kanosur të njëjtin me fjalë, “Ku e ke tani ...”, po ashtu me fjalët “ tërhiqe akuzën që të mos bëhet diçka e mos ta kalli shtëpinë, dhe e njëjta pas kësaj ka shkuar në shtëpi ku e ka lajmëruar policinë. Te njëjtën ditë policia e ka ndaluar tani të akuzuarin i cili ishte në afërsi te shtëpisë së tij dhe në dore mbante armen e tipit AK-47 marke ‘Cervena Zastava’ e kalibrit 7.62mm me 9 fishek e me të cilën armë i’ a kanë konfiskuar policia e Kosovës. I akuzuari në deklaratën e tij te dhëne në shqyrtim gjyqësorë ka qenë kontradiktore në pyetjen e prokurorit dhe se i njëjti ka rënë në kundërshtim me deklaratën e dhëne në polici, e këtë ka bërë me qellim që ti ikë përgjegjësisë penale. Nga raporti i ekspertizës mjeko-ligjore të IPF i datës 08.06.2018 u vërtetua se i njëjti ne momentit e kryerjes se veprës penale aftësia e te kuptuarit dhe kontrollit te veprimit ka qenë e zvogëluar por jo esencialisht, dhe se është i aftë që të përballë me gjykimi. Andaj nga të gjitha këto u vërtetua se i

akuzuari e ka kryer ketë vepër penale dhe propozoje nga gjykata që pas analizimit të të gjitha këtyre rrethanave, të marrë aktgjykim dënues duke e shpallur fajtor të akuzuarin, ndërsa me rastin e marrjes së vendimit lidhur me dënim t'i vlerësojë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

E dëmtuara në fjalën përfundimtare ka theksuar se e përkrah fjalën e prokurorit dhe i bashkangjitem ndjekjes penale.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se nuk ndihet fajtor për veprën penale e cila i vihjet në barrë, qëndroje mbrapa asaj që kam thënë me herët dhe nuk kam tjetër çfarë të shtojë.

Provat e administruara:

Në seancën e shqyrtimit gjyqësore të datës 16.04.2018, në cilësinë e dëshmitares është dëgjuar e dëmtuara S.P., e cila ka mes tjerave ka deklaruar se se ditën kritike, me dt.12.05.2018, rreth orës 12:00 ka shkuar tek varrezat në Fshatin ..., në mënyre që të vizitojë varrin e nënës, dhe pasi që jam kthyer nga varrezat S.C. ka qenë me pushkë në anën e djathtë, dhe më është drejtuar “Ku e ke tani ...”, “ku e ke tani Policinë”, unë jam frikësuar shumë, kam reaguuar qetë në mënyre që të mos me vriste, dhe në mënyre të qetë kam biseduar me të, sepse në të vërtete nuk kisha asnjë të keqe me të asnjëherë më parë, që ai të sillej ashtu me mua, pas kësaj është larguar në drejtim të pyllit, ndërsa unë kam shkuar në Polici. Edhe më herët më ka kërcënuar me anë të telefonit se do të më vras, edhe përmes mesazheve edhe përmes thirrjeve sepse ne fakte disa here me ka kërcënuar, ndërsa ne ditën kritike fakti se më ka thënë “ku e ke ... “ është fjala se ... punon ne policinë e Kosovës dhe po ashtu edhe kemi lidhje familjare me të, ai është bashkëshorti i motrës sime të ndjerë, dhe unë vetëm kisha kërkua nga ai që të më njoftojë se ku ta paraqes rastin. Më tutje shton se i akuzuari më ka thënë me një zë kërcënues që tërhiqe padinë, sepse do të pësojë ndonjë të keqe. Nuk e di arsyen pse më ka kërcënuar as unë, nuk kemi pasur asnjë kontakt, nuk kemi qenë as shok dhe as nuk jemi njohur, edhe unë çuditëm pse i akuzuari vazhdimisht qoftë përmes telefonit, apo sms mesazheve, ne vazhdimësi më ka shqetësuar, pra arsyen nuk e kam të qartë sa unë. Dëshmi të njëjtë ka dhënë edhe në polici me datë 12.05.2018, me ndonjë ndryshim të vogël.

Gjykata gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ka bërë administrimin e provave si në vijim: Raporti i policës të datës.12.05.2018, Fotodokumentacioni me përmbajta të sms mesazheve – 4 fotografi, dhe Raporti i Institutit të Psikiatrisë Forenzikës i datës 08.06.2018.

Në shqyrtimin gjyqësor, pas administrimit të provave, i akuzuari S.C. e ka paraqitur mbrojtjen e tij, e ka pranuar faktin se e ka takuar të dëmtuarën në ditën kritike, ka theksuar se numrin e telefonit të të dëmtuarës e ka pasur më herët nuk e di si e kam siguruar, nuk i kam dërguar sms mesazhe të dëmtuarës në ditën kritike. Poashtu ka theksuar se qëndroj prapa deklaratës që e kam dhënë në polici me datë 12.05.2018, mirëpo kur e kam dhënë deklaratën nuk më kanë lejuar që ta lexoj vetëm e kam nënshkruar.

Vlerësimi i gjykatëspër pikën I të dispozitivit të aktgjykimit:

Gjykata, pasi ka dëgjuar dëshmitari në këtë rast, provat materiale, mbrojtjen që ka paraqitur i akuzuari, pretendimet e palëve, gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se ditën kritike i akuzuari dhe e dëmtuara ishin takuar në dalje nga varrezat e fshatit Ky fakt përveç nga dëshmia e të dëmtuarës vërtetohet edhe nga

deklarata e të akuzuari dhënë në shqyrtimin gjyqësor, i cili në pyetjen e prokurorit se a e keni takuar të dëmtuarën në ditën kritike, datë 12.05.2018 në fshatin ..., përgjigjet: “po e kam takuar”.

Po ashtu nuk ishte kontestuese as fakti se ditën kritike i akuzuari kishte mbajtur armë me vete.

Nuk ishte kontestuese se fakti se ditën kritike, policia kishte konfiskuar nga i akuzuari armën automatike AK-47 e markës “Cervena Zastava” e kalibrit 7.62 mm, me numër serik 145, fakt ky që pranohet edhe nga i akuzuari.

Kontestuese në këtë çështje penale ishte fakti nëse i akuzuari e kishte kanosur të dëmtuarën ditën kritike me armë apo jo, ashtu siç e përshkruar e dëmtuara në dëshminë e dhënë në shqyrtimin gjyqësor por edhe në deklaratën e dhënë polici.

Gjykata ka vërtetuar faktin se ditën kritike i akuzuari i kishte ndalur në rrugë të dëmtuarës, derisa ajo po kthehej nga varrezat e fshatit ..., duke e kanosur me fjalë se nëse nuk e tërheq padinë do ta gjej ndonjë e keqe, respektivisht do t`ia djeg shtëpinë. Këtë fakt, Gjykata e ka vërtetuar nga dëshmia e dëshmitares – të dëmtuarës, e cila në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se: “me dt.12.05.2018, rreth orës 12:00 ka shkuar tek varrezat në Fshatin ..., në mënyre që të vizitojë varrin e nënës, dhe pasi që jam kthyer nga varrezat S.C. ka qenë me pushkë, ë cilën e mbante në dorën e djathte, dhe më është drejtuar “Ku e ke tani ...”, “ku e ke tani Policinë”, unë jam frikësuar shumë, pastaj më ka thënë, me një zë kërcënues, që tërhiqe padinë, sepse do te pësojë ndonjë të keqe”. Edhe në deklaratën e dhënë në polici me datë 12.05.2018 e dëmtuara e përshkruan njëjtë ngjarjen duke shtuar se i pandehuri e ka kanosur edhe me fjalët “kam qenë te ti në shtëpi, tërhiqe akuzë që të mos bëhet çkamos e mos ta djegi shtëpinë”. Këtë deklaratë e kishte pranuar në tërsi në shqyrtimin gjyqësor.

Nga Raporti i policisë i datës 12.05.2018, rreth orës 14:40 konstatohet se policia pasi që kishte marr informatën për një kanosje në fshatin ..., dhe me të arritur atje e kishin gjetur ankuesen dhe në bisedën informative që e kishin zhvilluar, e njëjta e kishte përshkruar një situatë të njëjtë si në deklaratën në polici, por edhe në dëshminë që e ka dhënë në shqyrtim gjyqësor.

Nga Raporti policisë i datës 12.05.2018 konstatohet se patrulla e Stacioni policor në Zveçan së bashku me tre pjesëtarë të njësisë intervenuese të Veriut të Mitrovicës, janë nisur në drejtim të fsh. ..., në mënyrë që ta gjejnë personin S.C., i njëjti është vërejtur në një largësi prej 300 metra nga shtëpia e tij, policia nuk është vënë në ndjekje të tij, por se kontakti me të është vënë përmes telefonit mobil dhe pas një orë negociatash i njëjti është dorëzuar vetë. Gjatë arrestimit S.C., nuk ka bërë kurrfarë rezistence, e me atë rast te ai është gjetur Pushka automatike AK-47 Cervena Zastava, e kalibrit 7.62mm me numër serik 145, ne te cilin kanë qenë 9 plumba.

Gjykata i ka besuar dëshmisë së të dëmtuarës – dëshmitares S.P. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, për arsyen se përveç që ishte e njëjtë me deklaratën e dhënë në polici, e njëjta ishte në lidhshmëri edhe provat e tjera materiale. Se i akuzuari kishte armë me vete, rrjedh se të njëjtën ditë, dhe atë vetëm pas më pak se dy orëve pas lajmërimit nga e të dëmtuarës të rastit në polici, policia kishte dalur në vendngjarje dhe e kishte takuar të akuzuari i cili në atë moment edhe kishte qenë i pajisur me armë. Po ashtu, edhe fakti se i akuzuari nuk ishte dorëzuar menjëherë, çka vetëm pas negociatave me policinë, i njëjti kishte pranuar që dorëzohej, dëshmon se i njëjti ka qenë i rrezikshëm në ato momente dhe vetëm pas një orë negociate ishte bindur që të dorëzohej tek policia. Kjo vërtetohet nga raporti i policisë i datës 12.05.2018.

Gjykata i ka besuar deklaratës së të dëmtuarës se i akuzuari kishte armë në ditën kritike, për arsyen se arma e konfiskuar nga i akuzuari ditën kritike përputhet me përshkrimin e armës të cilën e ka bërë e dëmtuara në shqyrtimin gjyqësor, ku në pyetjen e prokurori se “çfarë arme kishte i akuzuari” e dëmtuara është përgjigjur se: “arma ka qenë e gjatë, mirë po nuk e di se çfarë lloji”. Pra, se i akuzuari kishte pasur armë kur e ka takuar të dëmtuarën vërtetohet edhe nga kjo deklaratë cila është në harmoni të plotë me raportin e policisë të datës 12.05.2018 ku përshkruhet mënyra e arrestimit të të akuzuarit dhe arma e konfiskuar prej tij, që është një armë e markës AK-47, por edhe nga shikimi i fotografive shihet se bëhet fjalë për një armë të gjatë, ashtu siç e ka përshkruar e dëmtuara në deklaratën e saj, dhe për të cilin armë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtim gjyqësor.

Në shqyrtimin gjyqësor janë administruar edhe fotografitë nga ku shihen fotografitë me përmbajtje të sms-mesazhave të dërguar në numrin e të dëmtuarës dhe fotografitë të armës së marrë.

Po ashtu, se i akuzuari ishte takuar në ditën kritike, ashtu siç e përshkruar e dëmtuara, në mënyrë indirekte vërtetohet edhe nga përmbajtja e sms mesazheve të cilat i akuzuari i kishte dërguar të dëmtuarës, menjëherë pasi që policia ish vu në ndjekje të tij. Nga përmbajtja e këtyre sms mesazheve del se i akuzuari e kishte lutur të dëmtuarën (duke i përdor fjalët pashë kishë) që ta tërheq padinë (kallëzimin penal) të bërë në polici, duke e siguruar të dëmtuarën se nuk do ta shqetësoj më asnjëherë. Pra, nga kjo gjykata e vëren faktin se, lutja e të akuzuarit në këto mesazhe drejtuar të dëmtuarës për ta tërheq kallëzimin në polici, nënkupton se ai paraprakisht e kishte kanosur të dëmtuarën, dhe se ishte i frikësuar nga veprimet të cilat paraprakisht i kishte ndërmarrë ndaj të dëmtuarës.

Se këto sms mesazhe ishin dërguar nga i akuzuari, gjykata e ka vërtetuar përveç nga dëshmia e të dëmtuarës e cila e përshkruan ngjarjen sikur në deklaratën në polici ashtu edhe në dëshminë e dhënë shqyrtim gjyqësor, edhe nga mbrojtja e të akuzuarit i cili e pranon se ditën kritike i ka dërguar vetëm një sms mesazh të dëmtuarës. Pra, i akuzuari e pranon se ditën kritike i ka dërguar sms mesazh të dëmtuarës, por vetëm një, duke mos e specifikuar se çfarë përmbajtje ka pasur ai sms mesazh. Pra, Gjykata i ka besuar dëshmisë së të dëmtuarës për sms mesazhet pasi që e njëjta kishte mbështetje edhe në provat e tjera.

Gjykata pjesërisht i besoi dëshmisë së të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor ngase ajo përveç që nuk ishte në harmoni me provat e tjera, ishte në kundërshtim edhe me deklaratën e vetë të akuzuarit dhënë në polici, dhe se këtë shmangie gjykata e vlerëson si tendencë të të akuzuarit për ti ikur përgjegjësisë penale. Në deklaratën në polici i njëjti e ka mohuar faktin se ditën kritike e ka takuar të dëmtuarën, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari e ka pranuar se ditën kritike e ka takuar të dëmtuarën, duke mos specifikuar se ku e ka takuar.

Edhe deklarimi i të pandehurit i dhënë procedurën paraprake se jam i sëmur psikik dhe që nuk kam qenë i vetëdijshëm për veprimet e mia, nuk kishte mbështetje në provat e tjera. Kjo pasi që raportin mbi ekzaminimin psikiatrik të datës 08.06.2018, i hartuar nga: Dr. A.G., Dr.B.O., dhe, Dr. V.B.-R., konstaton se i ekzaminuari nuk vuan nga çrregullimi i kualitetit psikotik, ai është i vetëdijshëm për ambientin që e rrethon. Ai nuk vuan nga prapambetja mendore, të i njëjti është konstatuar çrregullimi i personalitetit- i paspecifikuar.

Ne momentin e kryerjes se veprës për te cilën ngarkohet aftësia e te kuptuarit dhe kontrolles së veprimeve të veta ka qenë e zvogëluar, po jo esencialisht dhe ai është i aftë të konsultohet me persona të tjerë dhe është i aftë të përballet me gjykimin. Këtij raporti gjykata i besoi në tërsi nga se ishte në rrjedh logjike me mënyrën e hartimit, ishte i logjikshëm dhe se nuk kishte prova tjera që e mbështesin të kundërtën, ngase nuk kishte ndonjë raport se i pandehuri ka vuajtura ndonjëherë nga ndonjë çrregullim psikik.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në bazë të provave të administruara u vërtetua në mënyrë të pakontestueshme se në veprimet e të akuzuarit janë përmbushur të gjitha elementet e përgjithshme dhe të veçanta të veprës penale: Kanosje nga neni 185 par. 4 të KPRK-së.

Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësorë përtej çdo dyshimi vërtetohet se i akuzuari kishte ndërmarr veprimet në drejtim të kryerjes së veprës penale ashtuqë ditën kritike me dt.12.05.2018, rreth orës 12:00 min, i pajisur me armën siç përshkruhet në dispozitivin II i kishte dalë në rrugë të dëmtuarës duke e kanosur të njëjtë, me ç`ras si rezultat i veprimeve të tij tek e dëmtuara ishte shkaktuar ndjenja e frikës dhe e ankthit për jetën. Po ashtu, Gjykata gjen se, gjen se veprimet e të pandehurit të përshkruara si më lartë, pra kanosja që kishte ndërmarr me armë në drejtim të dëmtuarës, ka qenë haptazi i kundërligjshëm. I akuzuari me veprimet e tij, kishte shkaktuar frikë dhe ankth për jetën tek e dëmtuara si dhe kishte rrezikuar drejtpërdrejtë të mirat e mbrojtura me Kodin penal, që në këtë rast ishte atakuar integriteti trupor dhe ishte rrezikuar drejtpërdrejtë jeta e të dëmtuarës. Gjykata rikujton se veprimet e të pandehurit në këtë rast janë të sanksionuara me ligj si vepër penale të përcaktuara, si: Kanosje nga neni 185 par. 4 sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, e për të cilën vepër me të njëjtin nen është përcaktuar edhe sanksioni penale dhe atë, dënim me burgim prej një vit deri në pesë vjet.

Përveç elementeve të përgjithshme, Gjykata gjen se në veprimet e të akuzuarit, janë përmbushur edhe elementet e veçanta të veprës penale. Kjo për faktin se i akuzuari në këtë rast kishte vepruar me dashje direkte, kjo për faktin se ai ishte i vetëdijshme se veprimet e tij mund shkaktonte pasojë tek e dëmtuara dhe atë frikë dhe ankth për jetën e saj, e edhe përkundër këtyre fakteve i pandehuri e dëshironte shkaktimin e pasojës. I pandehuri, ditën kritike ishte pajisur me armë dhe kjo tregon se i kishte përcjell lëvizjen e të dëmtuarës, kur edhe i kishte thënë të dëmtuarës, “kam qenë në shtëpi tek ti”. Përveç kësaj, ai e kishte zgjedhur si vend të kryerje së veprës një vend malor, ku nuk ka qarkullim të njerëzve, vend i pabanueshëm, ku frika dhe ankthi tek e dëmtuara do të ishin më të mëdhaja.

Gjykata rikujton se fakti që i akuzuari kishte qenë i pajisur me armë dhe sidomos duke marr parasysh vendin ku ka ndodhur ngjarja respektivisht vepra, pasi që ishte një vend malor, pa praninë e njerëzve të tjerë, vend i pabanuar, i rrethuar nga mali, ka shkaktuar frikë të madhe dhe ankth për të dëmtuarën, me ç`rast edhe janë konsumuar elementet e veprës penale të kanosjes nga neni 185 par. 4, pasi që i akuzuari armën e ka pasur në dorë dhe se bëhet fjalë për një armë të gjatë, dhe se në bazë të të gjitha këtyre rrethanave, për të shkaktuar frikë dhe ankth tek e dëmtuara për jetë e saj, ka mjaftuar vetëm prania e armës në dorën e të akuzuarit, pavarësisht faktit nëse të njëjtën ia ka drejtuar të dëmtuarës apo jo.

Prandaj, si përfundim Gjykata, nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar për tej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale: Kanosje nga neni 185 par. 4 të KPRK.

Arsyet lidhur me vendimin në pikën II të aktgjykimit:

I akuzuari S.C., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me 16.04.2019, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, pika II e akuzës.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari S.C., për shkak të veprës penale: Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së. në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të akuzuarin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raportet policore të datës 12.05.2018; Vërtetimi mbi marrjen e sendeve 12.05.2018; Deklarata e të akuzuarit dhënë në polici e datës 12.05.2018; Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të akuzuarit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike por mund të bëjë ankesë sa i përket lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të akuzuarit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej çdo dyshimi se i akuzuari ka kryer veprën penale: Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së., për të cilën veprë penale është paraparë dënimi me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind euro (7.500) ose me burgim prej deri në pesë (5) vjet.

Caktimi i llojit dhe lartësisë së dënimit:

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 64 të KPPK-së. Gjykata, si rrethanë rënduese për të pandehurin ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, që gjykata ka vërtetuar se i pandehuri ishte i përgjegjshëm dhe përgjegjës për këtë veprë penale, i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e tij, veprën penale e kishte kryer me dashje direkte. Gjithashtu, si rrethanë rënduese është marrë parasysh kontributi esencial i të pandehurit të kjo veprë penale, rrezikshmërinë që paraqet kjo veprë penale, nga ku ka rrezikuar drejtpërdrejtë jetën e të dëmtuarit, duke i shkaktuar frikë dhe ankth për jetën. Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale nga i akuzuari për veprën penale si nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, rrethanat personale të kryerësit, pasi që i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, sjellja korrekte e të akuzuarit në gjykatë.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmit që i është shkaktuar vlerës së mbrojtur nga kryerja e kësaj veprë penale. Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmën si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, në kompensimin e palës së dëmtuar për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në

raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 41 të KPRK-së.

Gjykata, si në dispozitivi të Aktgjykimit ndaj të akuzuarit, ka shqiptuar edhe dënimin plotësues marrjen e sendit, respektivisht armëve, duke marre për baze sigurinë juridike po ashtu të njëjtat janë sende qe është rezultat i kryerjes se veprës penale sic vërtetohet me larte, ne mbështetje te nenit 282 par.1 e lidhur me par.2 nenpar.2.1 te KPP-es, es ku përcakton se armët te cilat janë krijuar apo përdorur ne veprën penale nga nenet 371 deri me 376 te Kodit Penal, pasuria qe është qenësisht e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marrë parasysh edhe gjetjet e gjyqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit, e lidhur me nenin 54 i KPPK-së, i cili përcakton se sendet e përdoruara apo te destinuara per kryerjen e veprës penale apo sendet te cilat janë rezultat i kryerjes se veprës penale do te konfiskohen, andaj per shkak te këtyre konstatimeve gjykata ka vendosur si në dispozitiv për konfiskimin e tyre.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit dhe masës së arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar, Gjykata e bazoi në nenin 83 të KPRK-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 per Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 te KPPK-ës nga arsyet e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.615/2018 dt.13.05.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.